



FLETORJA ZYRTARE

E

REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

Nr. 26

2002

Qershor

P Ë R M B A J T J A

	Faqe
Ligj nr. 8897 datë 16.5.2002	Për mbrojtjen e ajrit nga ndotja 825
Ligj nr. 8898 datë 16.5.2002	Për një shtesë në ligjin nr. 8291, datë 25.2.1998 “Kodi i etikës së policisë” 832
Ligj nr. 8899 datë 22.5.2002	Për përcaktimin e formës dhe të formulës së privatizimit të INSIG sha-së..... 833
Ligj nr. 8900 datë 23.5.2002	Për një shtesë në ligjin nr. 8563, datë 22.12.1999 “Për përcaktimin e formës dhe formulës së privatizimit të Bankës së Kursimeve sha”, ndryshuar me ligjin nr. 8806, datë 17.5.2001..... 835
Ligj nr. 8902 datë 23.5.2002	Për ratifikimin e “Marrëveshjes ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Selisë së Shenjtë për rregullimin e marrëdhënieve të ndërsjella” 836

		
Ligj nr. 8903 datë 23.5.2002	Për disa ndryshime në ligjin nr.8847, datë 19.12.2001 “Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2002”	839
Vendim i KM nr. 237, datë 6.6.2002	Për disa ndryshime në vendimin nr. 205, datë 13.4.1999 të Këshillit të Ministrave "Për dispozitat zbatuese të Kodit Doganor", me ndryshimet përkatëse.....	845
Vendim i KM nr. 240, datë 6.6.2002	Për mënyrën e ndarjes së të ardhurave që vijnë nga marrëveshjet e qirasë së "personave të stimuluar" në fushën turistike.....	845
Vendim i KM nr. 242, datë 6.6.2002	Për krijimin e zyrave rajonale të turizmit.....	846
Vendim i GjK nr. 115, datë 6.6.2002	Me objekt shfuqizimin si antikushtetues të vendimeve nr. 1234, datë 15.12.2000 të Gjykatës së Apelit të Tiranës dhe nr. 12, datë 10.1.2002 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë.....	847
Vendim i GjK nr. 117, datë 6.6.2002	Me objekt shfuqizimin si antikushtetues të vendimit nr.44, datë 23.5.2002 të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.....	849
	<i>Vendim për shpalljen të zhdukur të shtetasit Halit Shaban Ferhati.....</i>	851
	<i>Kërkesë për shpalljen të zhdukur të shtetasit Hysen Zerja</i>	851
	<i>Kërkesë për shpalljen të zhdukur të shtetasit Zenel Kaferi</i>	852
	<i>Vendim (i shkurtuar) për heqjen e zotësisë për të vepruar të shtetasit Fejzi Kotori.....</i>	852

L I G J
Nr. 8897, datë 16.5.2002

PËR MBROJTJEN E AJRIT NGA NDOTJA

Në mbështetje të neneve 78, 81 pika 1 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

K U V E N D I

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
V E N D O S I:

KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1

Qëllimi

Ky ligj ka për qëllim të garantojë të drejtën e shtetasve për të jetuar në një mjedis me ajër të pastër, duke mbrojtur shëndetin e njeriut, faunën, florën dhe vlerat natyrore e kulturore të mjedisit shqiptar nga ndotja e ajrit.

Neni 2

Përkufizime

Në kuptim të këtij ligji:

1. “Ajri” është ajri i jashtëm, i troposferës, që nuk përfshin ajrin në vendet e punës.
2. “Ndotës” është çdo substancë e lëngët, e ngurtë ose e gaztë, që ndryshon cilësinë e ajrit.
3. “Treguesi mjedisor” është treguesi që jep të dhëna për një dukuri mjedisore, duke e bërë atë të perceptueshme nëpërmjet vlerës numerike, matjes dhe komunikimit, nga ku:
 - a) “Treguesi mjedisor i gjendjes së ajrit” është treguesi që jep të dhëna për cilësinë e ajrit;
 - b) “Treguesi mjedisor i trysnisë në ajër” është e treguesi që jep të dhëna për trysnitë që ushtrojnë në ajër burimet e ndotjes.
4. “Gjendje smogu” është ndotja e tejskajshme e atmosferës, kur niveli i ndotjes tejkalon ndjeshëm normat e cilësisë së ajrit.
5. “Monitorimi” është procesi që realizon vlerësimin sistematik të treguesve mjedisorë.
6. “Burim ekzistues i ndotjes” është veprimtaria që ka filluar përpara hyrjes në fuqi të këtij ligji.
7. “Burim i ri ndotjeje” është veprimtaria që fillon pas hyrjes në fuqi të këtij ligji.
8. “Norma e cilësisë së ajrit” është vlera më e madhe e lejueshme e një treguesi mjedisor të gjendjes së ajrit dhe që shprehet me sasinë në peshë të një ndotësi në njësinë e vëllimit të ajrit.
9. “Norma e depozitimit” është vlera më e madhe e lejueshme e një treguesi mjedisor të gjendjes së ajrit dhe që ushtron ndikim në mjedisin pritës dhe që shprehet si sasia në peshë e tij në njësinë e sipërfaqes dhe për një kohë të dhënë.
10. “Norma e shkarkimeve në ajër” është sasia më e madhe e lejuar e ndotësit, që shkarkohet në ajër nga një burim ndotjeje, i cili nuk tejkalon nivelin e lejuar të treguesve mjedisorë të trysnisë, si dhe të shkallës së lejueshme të errësimit të tymit. Ajo shprehet si përqendrim në peshë ose në vëllim i ndotësit në gazin mbetës.
11. “Burim i lëvizshëm” quhet objekti që i shkarkon lëndët ndotëse, duke qenë në lëvizje.
12. “Operatori i burimit të ndotjes” është çdo person fizik ose juridik, pronar i një burimi ndotjeje.
13. “Autoriteti i mbrojtjes së ajrit” është Ministria e Mjedisit dhe organet e tjera të ngarkuara

nga akte të tjera normative për mbrojtjen e pastërtisë së ajrit.

Neni 3

Burimet e ndotjes dhe klasifikimi i tyre

Burimet e ndotjes së ajrit janë:

a) burimet e palëvizshme, të cilat përfshijnë impiantet teknologjike që kanë pajisje të palëvizshme për djegien e lëndëve të djegshme, pajisjet për procese teknologjike, minierat e qymyrit në qiell të hapur, zona me djegie spontane, të ngadaltë ose me shkarkim ndotësish, veprimtaritë ku puna që kryhet mund të shkaktojë ndotje të ajrit, magazinimet e çdo lloji e tipi të lëndëve të djegshme, për lëndë të para, për produkte dhe mbetje;

burime të lëvizshme të ndotjes.

2. Këshilli i Ministrave, me propozimin e Ministrit të Mjedisit, miraton edhe burime të tjera të ndotjes, që mund të shfaqen.

3. Në bazë të sasisë së prodhimit të nxehtësisë ose të përmbajtjes së ndotësve, burimet e ndotjes klasifikohen në:

a) burime të mëdha ndotjeje, që janë burimet e palëvizshme në impiante teknologjike, prodhimi termik i të cilave është më i madh se 5 Megawat (MW);

b) burime mesatare ndotjeje që janë burimet e palëvizshme në impiante teknologjike, prodhimi termik i të cilave është nga 0,2 deri në 5 Megawat (MW);

c) burime të vogla ndotjeje që janë burimet e palëvizshme në impiante teknologjike, prodhimi termik i të cilave është më i vogël se 0,2 Megawat (MW).

Burime të vogla ndotjeje cilësohen edhe pajisjet për procese teknologjike, që nuk përfshihen në burimet e mëdha dhe të mesme të ndotjes, veprimtaritë që shkaktojnë ndotjen e ajrit, magazinimet e karburanteve, të lëndëve të djegshme, të lëndëve të para për produkte, të mbetjeve dhe ndotësve të grumbulluar, si dhe teknikat, pajisjet dhe veprimtaritë, të cilat ndotin ajrin.

KREU II

TREGUESIT E CILËSISË SË AJRIT

Neni 4

Treguesit bazë

1. Treguesit mjedisorë bazë të gjendjes së ajrit shprehin përmbajtjen në ajër të lëndëve të gazta, të ngurta e të lëngëta, si më poshtë:

a) të lëndës së ngurtë, të grimcuar (aerosole, mjegull, tym, pluhur);

b) të oksidit të squfurit;

c) të oksidit të karbonit;

ç) të ozonit;

d) të plumbit (aerosol);

dh) të oksideve të azotit.

2. Për zona të veçanta dhe në varësi të natyrës së shkarkimeve në ajër, Këshilli i Ministrave, me propozimin e Ministrit të Mjedisit, miraton edhe tregues të tjerë mjedisorë të gjendjes së ajrit.

Neni 5

Miratimi i normave

Normat e cilësisë së ajrit, të depozitimit dhe normat specifike për zona të veçanta, miratohen nga Këshilli i Ministrave, me propozimin e Ministrit të Mjedisit dhe të Ministrit të Shëndetësisë.

KREU III

KUFIZIMI I SHKARKIMEVE NË AJËR

Neni 6
Kufizimet

1. Kufizimi i shkarkimeve në ajër realizohet nëpërmjet vendosjes dhe zbatimit të detyrueshëm të normave të shkarkimeve.

2. Këshilli i Ministrave, me propozimin e Ministrit të Mjedisit, miraton normat e shkarkimeve në ajër, bazuar në normat e Bashkimit Europian.

Neni 7
Normat e përkohshme

1. Për burimet ekzistuese të ndotjes së ajrit, që funksionojnë edhe pas hyrjes në fuqi të këtij ligji, kur niveli i teknikës dhe teknologjisë nuk lejon të zbatohen normat e shkarkimeve sipas këtij ligji, Ministri i Mjedisit autorizon vendosjen e normave të përkohshme. Normat e përkohshme dhe mënyrat për vendosjen e tyre miratohen nga Këshilli i Ministrave me propozimin e Ministrit të Mjedisit.

2. Kur edhe pas zbatimit të normave të përkohshme të shkarkimeve, burimi i ndotjes dëmton shëndetin e njeriut dhe mjedisin, Ministri i Mjedisit urdhëron mbylljen e tij.

Neni 8
Lartësitë e pajisjeve shkarkuese

Pajisjet shkarkuese të burimeve të ndotjes duhet të kenë lartësi të tillë, që vlera e treguesit mjedisor të gjendjes së ajrit të mos kalojë normën e lejuar të cilësisë për një ndotës të dhënë. Lartësia e pajisjeve shkarkuese caktohet, rast pas rasti, në lejen mjedisore.

Neni 9
Normat e shkarkimeve nga burimet e lëvizshme

1. Për burimet e lëvizshme, normat e shkarkimeve përcaktohen mbi bazën e treguesve mjedisorë të trysnisë në gazin e shfryrjes nga këto burime, të cilat janë: përmbajtja në të e blozës, e dyoksidit dhe e oksidit të karbonit, e oksideve të azotit, e hidrokarbureve dhe e plumbit.

2. Normat e shkarkimeve nga burime të lëvizshme miratohen me udhëzim të përbashkët të Ministrit të Mjedisit dhe të Ministrit Transportit dhe Telekomunikacionit.

KREU IV
DETYRIMET PËR MBROJTJEN E AJRIT

Neni 10
Detyrime të përgjithshme

1. Personat fizikë e juridikë, publikë e privatë, vendas ose të huaj, kanë detyrë të ruajnë pastërtinë e ajrit, ta mbrojnë atë nga ndotjet e shkaktuara nga veprimtaria që ushtrojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.

2. Prodhuesit, importuesit, eksportuesit, transportuesit, tregtuesit dhe përdoruesit e pajisjeve, prodhimeve, materialeve dhe substancave që ndotin ajrin, janë të detyruar të marrin masa që garantojnë mbrojtjen e pastërtisë së ajrit.

3. Prodhuesit dhe importuesit e burimeve të lëvizshme prodhojnë dhe importojnë vetëm ato mjete e pajisje që plotësojnë karakteristikat e markës dhe normat e shkarkimeve.

4. Burimet e lëvizshme me motorë me djegie të brendshme i nënshtrohen kontrollit të shkarkimeve të gazeve ndotës, sipas rregullave që përcakton Ministri i Transportit dhe Telekomunikacionit.

5. Prodhuesit, importuesit, eksportuesit, transportuesit dhe tregtuesit e lëndëve djegëse

detyrohen t'i prodhojnë, t'i importojnë dhe t'i tregtojnë ato në përputhje me kërkesat e cilësisë, të miratuara nga Këshilli i Ministrave, me propozimin e Ministrit të Mjedisit.

6. Ndalohet djegia e lëndëve të tjera, të ndryshme nga:

a) ato të përcaktuara nga prodhuesi i pajisjes dhe nga ato të përcaktuara në lejen e përdorimit të objektit, të prodhimit e të tregtimit të lëndëve djegëse;

b) lënda e djegshme e përcaktuar në parametrat teknikë ose në masat tekniko-organizative të vënies në veprim të burimeve të ndotjes.

7. Ndërtimi i impianteve të reja dhe rinovimi i impianteve ekzistuese lejohet vetëm me teknologjitë më të mira të mundshme të kohës.

Neni 11

Detyrimet kryesore të operatorëve të burimeve të palëvizshme të ndotjes

1. Operatorët e burimeve të mëdha dhe mesatare të ndotjes detyrohen:

a) t'i përdorin këto burime vetëm sipas kushteve teknike dhe kushteve të vëna në lejen mjedisore;

b) të respektojnë normat e shkarkimeve në ajër dhe të shkallës së lejueshme të errësimit të tymit, sipas dispozitave ligjore në fuqi;

c) të përgatisin rregullore teknike për funksionimin e burimeve të ndotjes, të cilat kontrollohen nga Inspektorati i Mbrojtjes së Mjedisit;

ç) të kryejnë monitorimin e shkarkimeve në ajër dhe të publikojnë periodikisht të dhënat e tij, si dhe masat e marra për kufizimin e ndotjes;

d) të ndalin, në rast aksidenti, kur kërcënohet ose ulet në mënyrë të rrezikshme cilësia e ajrit, çdo burim ndotjeje dhe të marrin masat që urdhëron Inspektorati i Mbrojtjes së Mjedisit, për të garantuar cilësinë e ajrit. Të njoftojnë publikun për gjendjen dhe masat që marrin për normalizimin e gjendjes.

2. Operatorët e burimeve të mëdha të ndotjes përgatisin listën e parametrave teknikë, operacionalë dhe masat tekniko-organizative, që sigurojnë veprimtarinë normale të burimit të ndotjes, të cilat kontrollohen nga Inspektorati i Mbrojtjes së Mjedisit.

3. Operatorët e burimeve të vogla të ndotjes detyrohen të plotësojnë të gjitha kërkesat e shkronjave "a", "b" dhe "ç", të pikës 1 të këtij neni.

Neni 12

Detyrimet kryesore të operatorëve të burimeve të lëvizshme të ndotjes

Operatorët e burimeve të lëvizshme të ndotjes detyrohen t'i përdorin dhe t'i mirëmbajnë ato në përputhje me kushtet e përcaktuara nga prodhuesit e tyre, në pajtim me normat e shkarkimeve, të respektojnë masat që udhëzon Ministri i Mjedisit dhe pushteti vendor për zonat që kërkojnë mbrojtje të veçantë të cilësisë së ajrit.

KREU V

ZONAT ME MBROJTJE TË VEÇANTË

Neni 13

Shpallja dhe mbrojtja e tyre

1. Territorët e kufizuara dhe me ndotje të madhe ajri, me propozimin e Ministrit të Mjedisit dhe Ministrit të Shëndetësisë, shpallen nga Këshilli i Ministrave si zona që kërkojnë mbrojtje të veçantë të ajrit.

2. Për zonat me mbrojtje të veçantë, Ministri i Mjedisit, Ministri i Shëndetësisë dhe qeverisja vendore përkatëse udhëzojnë masa të veçanta për mbrojtjen e cilësisë së ajrit.

3. Në zonat me mbrojtje të veçantë, për qëllimet e sistemit rregullator e të paralajmërimit të smogut, ngrihen sisteme paralajmëruese e sinjalizuese të smogut, si dhe hartohen masat emergjente, që do të merren nga organet shtetërore dhe operatorët për të normalizuar gjendjen.

4. Kriteret e ngritjes dhe të vënies në funksionim të sistemit paralajmërues për smogun, miratohen nga Këshilli i Ministrave, me propozimin e Ministrit të Mjedisit.

Neni 14

Gjendja e smogut

1. Për të parashikuar dhe paralajmëruar gjendjen e smogut, ngrihen sistemet paralajmëruese dhe rregullatore për smogun.

2. Ministria e Mjedisit, në bashkëpunim me institute të specializuara, harton kriteret e ngritjes dhe të funksionimit të këtyre sistemeve, të cilat miratohen nga Këshilli i Ministrave.

Neni 15

Masat për përballimin e smogut

1. Kur parashikohet gjendje smogu, Ministria e Mjedisit shpall masat paralajmëruese, njofton Këshillin e Ministrave, qeverisjen vendore përkatëse dhe publikun e interesuar.

2. Në një gjendje smogu, Ministri i Mjedisit shpall masa rregullimi, për të ndaluar dhe kufizuar shkarkimet nga burimet e ndotjes së ajrit.

3. Për zvogëlimin dhe shmangien e smogut, operatorët zbatojnë masat e paralajmërimit e të rregullimit, si dhe njoftojnë periodikisht publikun, qeverisjen vendore dhe Ministrinë e Mjedisit.

KREU VI

NJOFTIMI

Neni 16

Njoftimi për ndotjen e ajrit

1. Të gjithë operatorët, që shkarkojnë ndotës në ajër, detyrohen të publikojnë të dhënat për ndotjen e ajrit dhe të dërgojnë periodikisht njoftim të plotë në Ministrinë e Mjedisit.

2. Ministria e Mjedisit, në rast të gjendjeve të ndotjeve të tejskajshme dhe të smogut, njofton publikun e gjerë me të gjitha mjetet e komunikimit.

3. Ministria e Mjedisit përgatit inventarin e shkarkimeve në ajër në nivel kombëtar, rrethi, qyteti dhe burimi individual ndotjeje. Një kopje e këtij inventari i dërgohet Institutit të Statistikave.

4. Institucionet e ngarkuara për njoftimin për ndotjen e ajrit i raportojnë periodikisht Ministrisë së Mjedisit rezultatet e ndotjes. Rregullat, procedurat dhe afatet e raportimit përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave, me propozimin e Ministrit të Mjedisit.

KREU VII

PAJISJA ME LEJE MJEDISORE E VEPRIMTARIVE QË NDOTIN AJRIN

Neni 17

Leja mjedisore për ndotësit e ajrit

Personat fizikë dhe juridikë vendas ose të huaj detyrohen të pajisen me leje mjedisore nga Ministria e Mjedisit në bashkëpunim me qeverisjen vendore për:

a) ndërtimin dhe shfrytëzimin e burimeve të mëdha dhe të mesme të ndotjes, si dhe për ndryshimet e tyre të mëvonshme;

b) projektimin e tipit standard dhe të projektmodelit për ndërtimin e burimeve të mëdha dhe të mesme të ndotjes;

c) zbatimin e projekteve, ku përfshihen teknologji dhe prodhime të reja burimesh të mëdha dhe të mesme të ndotjes;

ç) ndryshime të standardeve teknike dhe normave të shkarkimeve të gazta nga burime të ndryshme ndotjeje, kur zbatimi i tyre cenon mbrojtjen e ajrit;

- d) ndërtimin e burimeve të vogla të ndotjes, kur dokumentacioni i tij nuk miratohet, sipas një tipi standard ose projektmodeli;
- dh) ndryshimin e lëndëve djegëse dhe të lëndëve të para, që përdor burimi ndotës;
- e) prodhimin, importin dhe tregtimin e lëndëve djegëse, pajisjeve fikse, materialeve dhe produkteve, që ndotin ose mund të ndotin ajrin;
- ë) ndryshimin e parametrave teknikë, operacionalë dhe të masave tekniko-organizative të burimit të ndotjes.

KREU VIII TAKSA PËR NDOTJEN E AJRIT

Neni 18 **Taksa për shkarkimet në ajër**

Për ndotjen e ajrit, operatorët e burimit të ndotjes paguajnë taksë shkarkimesh, sipas sasisë dhe tipit të ndotësve të shkarkuar, sipas përcaktimeve në ligjin nr.8435, datë 28.12.1998 “Për sistemin e taksave në Republikën e Shqipërisë”.

KREU IX SANKSIONET NDAJ NDOTËSVE TË AJRIT

Neni 19

1. Në kuptim të këtij ligji, kur nuk përbëjnë kundërvajtje penale, përbëjnë kundërvajtje administrative dhe dënohen si më poshtë:

a) ushtrimi i veprimtarive në kundërshtim me nenin 17 të këtij ligji, pa leje mjedisore dhe dënohet me gjobë nga 10 mijë deri në 1 milion lekë dhe pezullim të veprimtarisë deri në 3 muaj, kohë brenda së cilës subjekti duhet të pajiset me leje mjedisore;

b) prodhimi, importimi ose tregtimi i lëndëve djegëse nga subjekte në kundërshtim me kërkesat e nenit 10 pika 5 të këtij ligji dhe dënohet me gjobë nga 10 mijë deri në 500 mijë lekë, në varësi të sasisë dhe rrezikshmërisë që paraqesin lëndët djegëse të palejuara, si dhe bën sekuestrimin e lëndës djegëse që është gjendje;

c) përdorimi i lëndëve djegëse të ndaluara nga operatori, në kundërshtim me kërkesat e nenit 10 pika 6 dhe dënohet me gjobë nga 10 mijë deri në 1 milion lekë në varësi të sasisë dhe rrezikshmërisë që paraqesin lëndët djegëse, si dhe vendos pezullimin e veprimtarisë, për aq kohë sa të bëhet zëvendësimi i lëndës djegëse;

ç) prodhimi ose importimi nga ana e subjekteve të lëvizshme, në kundërshtim me nenin 10 pika 3 që nuk plotëson karakteristikat e markës dhe normat e shkarkimit dhe dënohet me gjobë nga 10 mijë deri në 300 mijë lekë, në varësi të sasisë së prodhimit dhe importit, si dhe vendos mbylljen e përhershme të veprimtarisë;

d) ndotja e ajrit nga operatori i burimit të madh dhe të mesëm, duke shkelur normat e shkarkimit, normat në zona me mbrojtje të veçantë, rregullat në gjendje smogu a emergjence, kushtet teknike dhe kërkesat e përcaktuara në lejen mjedisore dhe dënohet me gjobë nga 10 mijë deri në 1 milion lekë, në varësi nga lloji dhe sasia e shkarkimeve ndotëse, si dhe ndërprerjen e veprimtarisë së burimit ndotës për aq kohë sa operatori të sjellë shkarkimet në normë.

2. Organi që vendos gjobën dhe bën ekzekutimin e saj, si dhe pezullimin ose ndërprerjen e veprimtarisë, sipas këtij neni, është Inspektorati i Mbrojtjes së Mjedisit.

3. Kur këto shkelje përbëjnë vepër penale, Inspektorati i Mbrojtjes së Mjedisit bën kallëzimin për ndjekje penale.

Neni 20 **Shfuqizimi**

Paragrafi i parë i pikës 2 të nenit 15 të ligjit nr.8364, datë 2.7.1998 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.7664, datë 21.1.1993 “Për mbrojtjen e mjedisit””, shfuqizohet.

Neni 21
Akte nënligjore

1. Ngarkohet Këshilli i Ministrave që, me hyrjen në fuqi të këtij ligji, të nxjerrë aktet nënligjore për zbatimin e neneve 3, 4, 5, 6, 7, 10, 13, 14 dhe 16 të tij.

2. Ngarkohen ministrat përkatës që, me hyrjen në fuqi të këtij ligji, të nxjerrin aktet nënligjore për zbatimin e neneve 5, 7, 9, 12, 13, 15 dhe 16 të tij.

Neni 22

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr. 3361, datë 4.6.2002 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Rexhep Meidani

L I G J
Nr. 8898, datë 16.5.2002

PËR NJË SHITESË NË LIGJIN NR.8291, DATË 25.2.1998
“KODI I ETIKËS SË POLICISË”

Në mbështetje të neneve 78, 81 pika 1 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

K U V E N D I

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
V E N D O S I:

Neni 1

Në ligjin nr.8291, datë 25.2.1998 “Kodi i etikës së policisë”, pas nenit 16 shtohet neni 16/1 me këtë përmbajtje:

“Neni 16/1

Ngarkohet Ministri i Rendit Publik të nxjerrë aktet nënligjore në zbatim të neneve 3, 4, 6, 7, 8, 10 dhe 11 të këtij ligji”.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr. 3352, datë 30.5.2002 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Rexhep Meidani

L I G J
Nr. 8899, datë 22.5.2002

PËR PËRCAKTIMIN E FORMËS DHE TË FORMULËS SË PRIVATIZIMIT TË INSIG SHA-SË

Në mbështetje të neneve 78, 81 pika 1 dhe 83 pikat 1 dhe 2 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

K U V E N D I

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË V E N D O S I:

Neni 1

Objekti

Ky ligj përcakton formën dhe formulën e privatizimit të Institutit të Sigurimeve INSIG sha-së.

Neni 2

Përkufizime

Në kuptim të këtij ligji:

1. “Aksion” nënkupton një aksion në kapitalin e INSIG sha-së.
2. “Institucione financiare ndërkombëtare” nënkupton institucionet e krijuara sipas marrëveshjeve ndërkombëtare, që veprojnë në sektorët e investimeve financiare, dhe shoqëritë risiguruese ndërkombëtare, të njohura në tregun ndërkombëtar të sigurimeve.
3. “Investitor strategjik” nënkupton një shoqëri të huaj sigurimesh e njohur në tregun ndërkombëtar të sigurimeve, e cila nuk është rezidente në territorin e Republikës së Shqipërisë dhe nuk është themeluar sipas ligjit shqiptar, e cila ka sukses në një ose më shumë tregje të huaja sigurimesh gjatë 20 viteve të fundit dhe ka të paktën 250 milionë USD asete neto dhe 1,5 miliard USD të totalit të aseteve.
4. “Subjekt i sektorit privat shqiptar” nënkupton një shoqëri shqiptare, rezidente në territorin e Republikës së Shqipërisë ose e themeluar sipas ligjit shqiptar.

Neni 3

Forma e privatizimit

1. Forma e privatizimit të INSIG sha-së është ajo e transferimit me anë të shitjes të së drejtës së pronësisë mbi aksionet ekzistuese të shoqërisë, nëpërmjet negociatave me institucionet financiare ndërkombëtare dhe përzgjedhjes së investitorëve strategjikë, nëpërmjet procedurave të tenderit të hapur ndërkombëtar, sipas formulës së parashikuar në nenin 4 të këtij ligji.
2. Vlera e aksioneve, me të cilën do të fillojnë negociatat për shitjen e tyre institucioneve ndërkombëtare financiare, bëhet nga një vlerësues ndërkombëtar i njohur në këtë fushë, i cili do të zgjidhet, sipas procedurave të tenderit të hapur ndërkombëtar. Kjo vlerë miratohet nga Këshilli i Ministrave, i cili miraton edhe marrëveshjen për transferimin e të drejtës së pronësisë së aksioneve të shoqërisë anonime INSIG sha, me anë të negociatave me institucionet financiare ndërkombëtare.

Neni 4

Formula e privatizimit

Struktura e formulës së privatizimit të INSIG sha-së është si më poshtë:

1. Jo më shumë se 40 për qind e aksioneve transferohen nëpërmjet shitjes, me anë të negociatave me institucionet financiare ndërkombëtare, jo më vonë se 12 muaj nga data e hyrjes në fuqi të këtij ligji.
2. Jo më pak se 60 për qind e aksioneve u shiten investitorëve strategjikë dhe subjekteve të sektorit privat shqiptar. Nga kjo paketë aksionesh ofrohen për shitje jo më pak se 51 për qind për investitorin strategjik dhe pjesa e mbetur u ofrohet për shitje subjekteve të sektorit privat shqiptar me

ofertë publike. Përzgjedhja e investitorit strategjik për blerjen e aksioneve bëhet brenda 12 muajve nga data e hyrjes në fuqi të marrëveshjes për transferimin e aksioneve institucioneve financiare ndërkombëtare dhe, në asnjë rast, nuk mund të zgjasë më shumë se 24 muaj. Procedurat për shitjen e aksioneve për investitorët strategjikë, sipas parashikimeve të kësaj pike, bëhen nga Ministria e Financave dhe institucionet financiare ndërkombëtare, me cilësinë e aksionerëve në këtë shoqëri, procedura të cilat do të jenë ato të tenderit të hapur ndërkombëtar.

Neni 5

Monedha e pagesës

Transferimi i aksioneve investitorëve të përzgjedhur, sipas këtij ligji, përfshirë institucionet financiare ndërkombëtare dhe investitorët strategjikë, bëhet në një monedhë të huaj, të përcaktuar nga shitësi i aksioneve. Në rastin e shitjes së aksioneve subjekteve të sektorit privat shqiptar, pagesa e tyre kryhet në një monedhë të huaj të përcaktuar, ose në lekë, e konvertuar me kursin ditor të bankës ku kryhet pagesa.

Neni 6

Aksionet e mbetura

Në rast se pas përzgjedhjes së investitorëve strategjikë dhe të institucioneve financiare ndërkombëtare, sipas nenit 4 të këtij ligji, mbeten aksione të pashitura, ato u shiten nga Ministria e Financave, brenda 5 vjetëve, nëpërmjet ofertës publike, subjekteve të sektorit privat shqiptar.

Neni 7

Detyrime të investitorëve

1. Investitorët pjesëmarrës në procesin e privatizimit të INSIG sha-së janë të detyruar të plotësojnë të gjitha kërkesat e parashikuara nga legjislacioni në fuqi dhe, në mënyrë të veçantë, kërkesat e parashikuara nga legjislacioni tregtar dhe ai i sigurimeve në Republikën e Shqipërisë.

2. Investitorët e përzgjedhur sipas këtij ligji duhet të bien dakord, si një kusht paraprak për zotërimin e aksioneve të shoqërisë INSIG sha, për të miratuar çdo ndryshim të nevojshëm të statutit të INSIG sha-së, për nënshkrimin e aksioneve të shoqërisë nga aksionerët e rinj, siç parashikohet në këtë ligj, dhe të mbrojnë të drejtat e aksionerëve në minorancë të shoqërisë, sipas standardeve moderne të drejtimit të përbashkët.

Neni 8

Zbatimi i privatizimit

Ministria e Financave, në bashkëpunim me institucionet financiare ndërkombëtare, të cilave u është transferuar paketa e aksioneve, sipas pikës 1 të nenit 4 të këtij ligji, të kryejnë procedurat e privatizimit të INSIG sha-së, në zbatim të këtij ligji dhe të akteve të miratuara sipas nenit 9 të këtij ligji.

Neni 9

Nxjerrja e akteve

Këshilli i Ministrave, në zbatim të pikës 2 të nenit 4 të këtij ligji, miraton aktet nënligjore për procedurat e përzgjedhjes së investitorit strategjik.

Neni 10

Zgjidhja e investimeve

Ministria e Financave të paraqesë për miratim përpara procesit të privatizimit të INSIG-sha-së aktet e nevojshme nënligjore për zgjidhjen e problemeve të investimeve të kryera nga INSIG sha-ja, për të rritur vlerën e shitjes së kësaj shoqërie.

Neni 11

Ministria e Financave dhe Komisioni i Mbikëqyrjes i Sigurimeve të nxjerrin, brenda datës 31.10.2002, aktet e nevojshme nënligjore për zbatimin e këtij ligji.

Neni 12

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr. 3364, datë 5.6.2002 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Rexhep Meidani

L I G J
Nr. 8900, datë 23.5.2002

**PËR NJË SHITESË NË LIGJIN NR.8563, DATË 22.12.1999 “PËR PËRCAKTIMIN E
FORMËS DHE FORMULËS SË PRIVATIZIMIT TË BANKËS SË KURSIMEVE SHA”,
NDRYSHUAR ME LIGJIN NR.8806, DATË 17.5.2001**

Në mbështetje të neneve 78, 81 pika 1 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

K U V E N D I

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
V E N D O S I:

Neni 1

Pas nenit 7 të ligjit nr.8563, datë 22.12.1999 “Për përcaktimin e formës dhe formulës së privatizimit të Bankës së Kursimeve sha”, ndryshuar me ligjin nr.8806, datë 17.5.2001, shtohet neni 7/1 me këtë përmbajtje:

“Neni 7/1

1. Banka e Kursimeve sha deri më 31.12.2010 nuk do t’u nënshtrohet detyrimeve të neneve 5, 6, 7 dhe 8 të ligjit nr.8044, datë 7.12.1995 “Për konkurrencën”. Gjatë kësaj periudhe Banka e Kursimeve do t’u nënshtrohet dispozitave ligjore në fuqi, që trajtojnë abuzimin me pozitën dominuese në treg.

2. Ngarkohen Banka e Shqipërisë dhe Ministria e Ekonomisë të përcaktojnë norma specifike të mbikëqyrjes për moslejimin e rasteve të abuzimit me pozitën dominuese në treg”.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr. 3370, datë 14.6.2002 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Rexhep Meidani

L I G J
Nr. 8902, datë 23.5.2002

**PËR RATIFIKIMIN E “MARRËVESHJES NDËRMJET REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
DHE SELISË SË SHENJTË PËR RREGULLIMIN E MARRËDHËNIEVE TË
NDËRSJELLA”**

Në mbështetje të neneve 10 pika 5, 78, 81 pika 1, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

K U V E N D I

**I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
V E N D O S I:**

Neni 1

Ratifikohet “Marrëveshja ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Selisë së Shenjtë për rregullimin e marrëdhënieve të ndërsjella”.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr. 3371, datë 14.6.2002 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Rexhep Meidani

MARRËVESHJE
NDËRMJET REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE SELISË SË SHENJTË
PËR RREGULLIMIN E MARRËDHËNIEVE RECIPROKE

Republika e Shqipërisë dhe Selia e Shenjtë, duke pasur dëshirën e përbashkët për të forcuar dhe zhvilluar, në frymën e miqësisë, marrëdhëniet ekzistuese midis tyre,
dhe me qëllimin për të rregulluar përmes një marrëveshjeje të përbashkët statusin juridik të Kishës Katolike në Shqipëri,
bien dakord si më poshtë:

Neni 1

Republika e Shqipërisë garanton lirinë për të shpallur dhe praktikuar në publik Fenë Katolike. Kisha Katolike në Shqipëri ka të drejtë të organizohet dhe të plotësojë misionin e saj.

Neni 2

Republika e Shqipërisë njeh zotësinë juridike të personave ligjorë për entitete të tilla të Kishës Katolike, të cilat janë të parashikuara në të Drejtën Kanonike, si arqidioqezat, dioqezat apo administratat apostolike famullitë, bashkësitë fetare, misionet, shoqatat, seminarët, shkollat dhe institucionet arsimore të të gjitha niveleve, institucionet shëndetësore, pas regjistrimit të tyre nga organet e drejtësisë.

Neni 3

Selia e Shenjtë dhe Kisha Katolike në Shqipëri gëzojnë lirinë e plotë të komunikimit dhe të korrespondencës me njëra-tjetrën.

Republika e Shqipërisë dhe Selia e Shenjtë do të mbajnë marrëdhënie diplomatike në nivelin e Ambasadës dhe Nunciaturës Apostolike.

Neni 4

Kisha Katolike ka të drejtën të posedojë mjete të veta të komunikimit masiv dhe ka të drejtën të përdorë mjetet publike të komunikimit masiv, në përputhje me legjislacionin e Republikës së Shqipërisë.

Neni 5

Autoriteti kompetent kishtar ka të drejtë të krijojë strukturat përkatëse të Kishës, e në veçanti, të krijojë dhe të modifikojë personat juridikë kishtarë, në përputhje me të Drejtën Kanonike dhe duke respektuar ligjet shqiptare.

Selia e Shenjtë është e lirë të zgjedhë një klerik në detyrën e Ipeshkvit ose të Administratorit Apostolik, i cili mund të jetë dhe Ipeshkëv.

Përpara se të publikojë emërimin e Ipeshkvit apo të Administratorit Apostolik, Selia e Shenjtë, për mirësjellje dhe në konfidencë, do të informojë Presidentin e Republikës së Shqipërisë nëpërmjet Ministrisë së Punëve të Jashtme.

Neni 6

Për të plotësuar përgjegjësitë që rrjedhin nga funksioni baritor, Ipeshkvi ose Administratori Apostolik ka të drejtë të ftojë në Shqipëri priftërinj, anëtarë të kongregacioneve rregulltare dhe persona laikë, të cilët nuk kanë nënshtetësinë shqiptare dhe të rekomandojë kërkesën e tyre për leje për rezidencë dhe për leje për punë drejtuar autoriteteve shqiptare, në përputhje me ligjet e Republikës së Shqipërisë.

Me kërkesën formale të Ipeshkvit ose të Administratorit Apostolik, leja për rezidencë dhe leja për punë, e nënkuptuar kjo për ushtrimin e aktivitetit baritor, do të lëshohen kundrejt një pagese minimale sipas legjislacionit dhe rregullave shqiptare.

Neni 7

Kisha Katolike ka të drejtë të hapë dhe të drejtojë shkollat, klinikat dhe qendrat sociale të saj sipas të Drejtës Kanonike dhe në përputhje me ligjet përkatëse të Republikës së Shqipërisë.

Neni 8

Republika e Shqipërisë do të kthejë pronat e Kishës Katolike, në përputhje me legjislacionin shqiptar, dhe do të asistojë riregjistrimin e tyre në emrin e Kishës Katolike në zyrat kompetente shtetërore.

Neni 9

Në rastet e çështjeve të dyshimta, të pazgjidhura dhe të diskutueshme, të cilat kanë të bëjnë me Kishën Katolike në Shqipëri në përgjithësi ose me komunitetet apo institucionet katolike në veçanti, Kisha Katolike në Shqipëri dhe autoriteti kompetent në Republikën e Shqipërisë do të krijojnë një komision “ad hoc” të përbashkët me detyrën për të gjetur zgjidhje të pranueshme nga të dyja Palët.

Neni 10

Nëse në të ardhmen do të lindin vështirësi në lidhje me dispozitat e mësipërme, që do të kenë të bëjnë me interpretimin apo aplikimin e tyre, Republika e Shqipërisë dhe Selia e Shenjtë do të procedojnë një marrëveshje të përbashkët për një zgjidhje miqësore.

Neni 11

Kjo Marrëveshje do të hyjë në fuqi në momentin e njoftimit reciprok për plotësin nga Palët të procedurave të tyre të brendshme të kërkuara për hyrjen e saj në fuqi.

Kjo Marrëveshje mund të zgjidhet prej secilës nga Palët që do të njoftojë Palën tjetër për vendimin e saj me shkrim. Marrëveshja do të pushojë së ekzistuari nëntëdhjetë (90) ditë pas ditës së njoftimit.

Për Republikën e Shqipërisë

Për Selinë e Shenjtë

L I G J

Nr. 8903, datë 23.5.2002

PËR DISA NDRYSHIME NË LIGJIN NR. 8847, DATË 19.12.2001 “PËR BUXHETIN E SHETITIT TË VITIT 2002”

Në mbështetje të neneve 78, 83, pika 1 dhe 158 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

K U V E N D I

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË V E N D O S I:

Në ligjin nr.8847, datë 19.12.2001 “Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2002” bëhen këto ndryshime:

Neni 1

Neni 1 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 1

Fondi i konsoliduar për vitin 2002 është:

Të ardhurat e Buxhetit të Shtetit	133 338 milionë lekë
Shpenzimet e Buxhetit të Shtetit.....	186 195 milionë lekë
Deficiti.....	52 857 milionë lekë

Fondi i konsoliduar përbëhet:

A) Buxheti qendror

Të ardhurat.....	130 338 milionë lekë
Shpenzimet.....	183 195 milionë lekë

B) Buxheti i pavarur i pushtetit vendor

Të ardhurat.....	12 500 milionë lekë
------------------	---------------------

Nga të cilat:	
Granti nga buxheti qendror.....	9 500 milionë lekë
Shpenzimet.....	12 500 milionë lekë.”.

Neni 2

Neni 2 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 2

Buxheti i sigurimeve shoqërore për vitin 2002 është:

A. Skema e sigurimit të detyrueshëm shoqëror

Të ardhurat, gjithsej.....	34 582 milionë lekë;
Nga kontributet.....	24 019 milionë lekë;
Transferimet nga Buxheti i Shtetit.....	10 563 milionë lekë;
Shpenzimet.....	34 582 milionë lekë.

Paga minimale për efekt të pagesës së kontributit të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore, deri në rritjen e pagave, është 8 396 lekë në muaj. Pas rritjes së pagave, Këshilli i Ministrave përcakton pagën e re.

B. Skema e sigurimit suplementar

Të ardhurat, gjithsej.....	1 468 milionë lekë
Nga kontributet.....	32 milionë lekë
Transferimet nga Buxheti i Shtetit.....	1 436 milionë lekë
Nga të cilat për:	
Sigurimin suplementar të ushtarakut.....	964 milionë lekë
Sigurime suplementare shtetërore.....	108 milionë lekë
Pagesat e parakohshme për minatorët.....	364 milionë lekë
Shpenzimet.....	1 468 milionë lekë.”.

Neni 3

Neni 3 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 3

Buxheti i sigurimeve shëndetësore për vitin 2002 është:

Të ardhurat, gjithsej.....	3 786 milionë lekë
Nga kontributet.....	1 956 milionë lekë
Të tjera.....	80 milionë lekë
Transferimet nga Buxheti i Shtetit.....	1 750 milionë lekë
Shpenzimet.....	3 786 milionë lekë.”.

Neni 4

Neni 4 i kreut II “Burimet për mbështetjen e shpenzimeve buxhetore” ndryshohet si më poshtë:

“Neni 4

Të ardhurat e Buxhetit të Shtetit, sipas grupeve kryesore janë:

Të ardhurat tatimore.....	109 800 milionë lekë
Të ardhurat jotatimore.....	20 538 milionë lekë

Të ardhurat e buxhetit vendor..... 3 000 milionë lekë.”.

Neni 5

Neni 5 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 5

Kufiri maksimal i financimit të deficitit të buxhetit të përgjithshëm nga burime të brendshme është 20 746 milionë lekë, 1 153 milionë lekë të të cilit do të financohen nga të ardhurat e privatizimit. Në rastet e mosrealizimit të të ardhurave nga privatizimi, huamarrja për financimin e deficitit të brendshëm prej 19 593 milionë lekësh nuk ndryshon. Këshilli i Ministrave merr masa për kompensimin e diferencave nga burime suplementare ose nga shkurtimi i shpenzimeve.

Kufiri i financimit nga burimet e huaja është 30 200 milionë lekë dhe mbështetja e drejtpërdrejtë për deficitin është 5 211 milionë lekë.”.

Neni 6

Neni 7 i kreut III “Shpenzimet e Buxhetit të Shtetit” ndryshohet si më poshtë:

“Neni 7

Shpenzimet, sipas drejtimeve kryesore, janë:

Shpenzimet korrente.....	132 378 milionë lekë
Shpenzimet kapitale.....	50 817 milionë lekë
Rezerva e Këshillit të Ministrave.....	2 000 milionë lekë
Kontingjenca.....	1 000 milionë lekë

Kufiri i shpenzimeve për çdo ministri dhe institucion, i ndarë në fonde të kushtëzuara dhe të pakushtëzuara, është sipas tabelës 1, e cila i bashkëlidhet këtij ligji.”.

Neni 7

Neni 8 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 8

Numri maksimal i punonjësve buxhetorë, sipas të cilit është përgatitur Buxheti i Shtetit i vitit 2002, është, më 1 prill 2002, 110 000 punonjës. Ngarkohet Këshilli i Ministrave të përcaktojë numrin e punonjësve buxhetorë për çdo ministri dhe institucion qendror. Fondi për rritjen e pagave prej 2 430 milionë lekësh përdoret me vendim të Këshillit të Ministrave, në përputhje me politikat e përcaktuara në këtë ligj.”.

Neni 8

Neni 9 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 9

Shpenzimet kapitale nga burimet e brendshme janë 24 317 milionë lekë, ndërsa nga burimet e huaja 26 500 milionë lekë. Investimet sipas ministrive dhe institucioneve paraqiten në tabelën 2, e cila i bashkëlidhet këtij ligji.”.

Neni 9

Neni 10 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 10

Fondi i kontingjencës prej 1000 milionë lekësh të përdoret për ruajtjen e deficitit, me miratimin e Kuvendit.”.

Neni 10

Në paragrafin e parë të nenit 13, shifra “2 800 milionë lekësh” zëvendësohet me shifrën “2900 milionë lekësh”.

Neni 11

Neni 15 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 15

Kufiri për rritjen vjetore të totalit ekzistues të borxhit të shtetit dhe atij të garantuar të shtetit, në dobi të palëve të treta përfituese është si më poshtë:

1. Kufiri për rritjen vjetore të totalit ekzistues të borxhit të shtetit, si rezultat i zbatimit të Buxhetit të Shtetit të vitit 2002, është 43 093 milionë lekë, nga i cili:

- Për kreditë e jashtme të drejtpërdrejta të Këshillit të Ministrave	23 500 milionë lekë
- Për financimin e brendshëm të deficitit buxhetor me bono thesari	19 593 milionë lekë

2. Kufiri për rritjen vjetore të garancive të shtetit në dobi të palëve të treta përfituese është 5300 milionë lekë.

3. Kufiri për rritjen vjetore të stokut të borxhit, si rezultat i riskedulimit të borxheve të vjetra të jashtme të papaguara, është 10 800 milionë lekë.”.

Neni 12

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr. 3354, datë 31.5.2002 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Rexhep Meidani

000 lekë

Kodmin	Buxheti i vitit 2002 sipas Ministrive dhe Institucioneve (në mijë lekë)	Fonde të pakushtëzuara	Fonde të kushtëzuara	Totali
1	Presidenca	87,730	0	87,730
2	Kuvendi	570,081	0	570,081
3	Këshilli i Ministrave	500,831	227,706	728,537
4	Ministria e Ek.Publike dhe Privatizimit	9,415,005	1,381,174	10,796,179
5	Ministria e Bujqësisë dhe Ushqimit	2,983,326	3,052,733	6,036,059
6	Ministria e Punëve Publike dhe Turizmit	4,698,678	4,561,778	9,260,456
7	Ministria e Bashkpunimit Ek. dhe Tregtisë	668,678	947,972	1,616,651
8	Ministria e Transportit	8,689,041	6,916,694	15,605,735
9	Kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme	95,411	96,000	191,411
10	Ministria e Financave	1,073,470	914,873	1,988,343
11	Ministria e Arsimit dhe Shkencës	17,730,218	2,723,152	20,453,370
12	Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve	1,112,382	410,550	1,522,932
13	Ministria e Shëndetësisë	11,965,357	3,100,000	15,065,357
14	Ministria e Drejtësisë	1,502,166	517,666	2,019,832
15	Ministria e Punëve të Jashtme	1,644,119	0	1,644,119

16	Ministria e Rendit Publik	8,801,448	1,697,000	10,498,448
17	Ministria e Mbrojtjes	7,207,656	762,413	7,970,069
18	Shërbimi Informativ Shtetëror	1,079,550	22,500	1,102,050
19	Drejtoria e Përgjithshme Radio-Televizionit	622,000	0	622,000
20	Arkivi i Shtetit	121,523	26,903	148,426
21	Drejtoria e Rezervës Shtetit	146,829	35,000	181,829
22	Akademia e Shkencave	438,657	41,000	479,657
24	Kontrolli i Lartë i Shtetit	150,779	0	150,779
25	Ministria e Punës dhe Çështjeve Sociale	22,621,826	204,137	22,825,963
26	Ministria e Mbrojtjes së Mjedisit	176,182	144,941	321,123
27	Agjensia Kombëtare e Privatizimit	30,117	110,000	140,117
28	Prokuroria e Përgjithshme	731,473	4,500	735,973
29	Buxheti i Pushtetit Gjyqsor	887,948	10,000	897,948
30	Gjykata Kushtetuese	83,488	0	83,488
31	Agjensia Telegrafike Shqiptare	89,966	6,000	95,966
32	Ministria e Pushtetit Vendor dhe Decentralizimit	1,091,102	5,000	1,096,102
35	Drejtoria e Doganave	527,617	944,500	1,472,117
37	Drejtoria e Standardeve	22,948	1,140	24,088
39	Drejtoria e Përgjithshme e Pyjeve	668,078	843,337	1,511,416
40	Partitë Politike	172,000	0	172,000
41	Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve	796,597	716,000	1,512,597
48	Drejtoria e Metereologjisë dhe Kalibrimit	16,000	0	16,000
50	Instituti i Statistikës	107,734	0	107,734
53	Komisioni i Letrave me Vlerë	19,000	0	19,000
54	Enti Kombëtar i Zonave të Lira	6,946	0	6,946
55	Shkolla e Magjistraturës	35,309	100	35,409
56	Fondi i Zhvillimit Shqiptar	600,000	2,301,248	2,901,248
57	Qendra Kombëtare e Kinematografisë	93,689	400	94,089
59	Instituti Rehab.Përndjekurve Politikë	27,849	0	27,849
63	Zyra e Këshillit të Lartë të Drejtësisë	23,454	0	23,454
64	Këshilli Kombëtar i RTV	89,000	0	89,000
66	Avokati i Popullit	69,294	0	69,294
67	Komisioni i Shërbimit Civil	50,147	0	50,147
73	Komisioni Qendror i Zgjedhjeve	111,524	0	111,524
	Total	110,454,223	32,726,419	143,180,642

në 000 lekë

Kodmin	Investimet e vitit 2002 sipas ministrive dhe institucioneve (në mijë lekë)	Nga Buxheti	Nga të Ardhurat	Financimi i Huaj	Totali
1	Presidenca	13,000			13,000
2	Kuvendi	43,000			43,000
3	Këshilli i Ministrave	117,820	10,00	189,706	317,526
4	Ministria e Ek. Publike dhe Privatizimit	1,554,500	33,500	1,196,833	2,784,833
5	Ministria e Bujqësisë dhe Ushqimit	1,475,000	25,000	2,992,533	4,492,533
6	Ministria e Punëve Publike dhe Turizmit	3,791,056	195,944	4,349,418	8,336,418
7	Ministria e Bashkëpunimit Ek. dhe Tregtisë	285,000		947,812	1,232,812
8	Ministria e Transportit	6,901,400	2,245	6,911,079	13,814,724
9	Kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme	7,200	30,000		37,200
10	Ministria e Financave	300,000		911,873	1,211,873
11	Ministria e Arsimit dhe Shkencës	2,270,000	100,000	2,427,627	4,797,627
12	Ministria e Kulturës Rinisë dhe Sporteve	313,500	316,500		630,000
13	Ministria e Shëndetësisë	1,503,000	140,000	2,755,000	4,398,000
14	Ministria e Drejtësisë	360,000		495,451	855,451
15	Ministria e Punëve të Jashtme	186,000			186,000
16	Ministria e Rendit Publik	329,683	294,048		623,731
17	Ministria e Mbrojtjes	371,852	319,148		691,000
18	Shërbimi Informativ Shtetëror	198,600	2,494		201,094
19	Drejtoria e Përgjithshme Radio-Televizionit	172,000			172,000
20	Arkivi i Shtetit	44,000	1,800	17,903	63,703
21	Drejtoria e Rezervës së Shtetit	0	10,000		10,000
22	Akademia e Shkencave	68,000	7,000		75,000
24	Kontrolli i Lartë i Shtetit	10,000			10,000
25	Ministria e Punës dhe Çështjeve Sociale	295,000	16,000	164,137	475,137
26	Ministria e Mbrojtjes Mjedisit	102,600	3,400	137,541	243,541

27	Agjensia Kombëtare e Privatizimit	0	20,000		20,000
28	Prokuroria e Përgjithshme	110,000	500		110,500
29	Buxheti i Pushtetit Gjyqësor	228,100	2,000		230,100
30	Gjykata Kushtetuese	27,000			27,000
31	Agjensia Telegrafike Shqiptare	16,500	1,500		18,000
32	Ministria e Pushtetit Vendor dhe Decentralizimit	168,000	5,000		173,000
35	Drejtoria e Doganave	0	300,000		300,000
37	Drejtoria e Standardeve	1,950	342		2,292
39	Drejtoria e Përgjithshme e Pyjeve	144,200	96,500	701,837	942,537
40	Partitë Politike	0			0
41	Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve	0	256,000		256,000
48	Drejtoria e Metereologjisë dhe Kalibrimit	2,500			2,500
50	Instituti i Statistikës	2,500			2,500
53	Komisioni i Letrave me Vlerë	1,500			1,500
54	Enti Kombëtar i Zonave të Lira	1,500			1,500
55	Shkolla e Magjistraturës	3,000			3,000
56	Fondi i Zhvillimit Shqiptar	600,000		2,301,248	2,901,248
57	Qendra Kombëtare e Kinematografisë	2,800			2,800
59	Instituti i Rehab.Përndjekurve Politikë	4,500			4,500
63	Zyra e Këshillit të Lartë të Drejtësisë	5,000			5,000
64	Këshilli Kombëtar i RTV	55,000			55,000
66	Avokati i Popullit	9,000			9,000
67	Komisioni i Shërbimit Civil	12,500			12,500
73	Komisioni Qendror i Zgjedhjeve	20,000			20,000
	Totali	22,127,761	2,188,921	26,500,000	50,816,682

Buxheti i Pushtetit Gjyqësor për vitin 2002

Nr.	Emërtimi	Korente	Investime	Totali
1.	Gjykata e Lartë	98,000	21,000	119,000
2.	Gjykata e Apelit	100,000	24,200	124,200
3.	Gjykata e Faktit	455,848	172,100	627,948
4.	Z.A.B.GJ.	14,000	12,800	26,800
	Totali	667,848	230,100	897,948

Të tjera shpenzime të papërfshira në buxhetet e ministrive dhe institucioneve

Fondi rezervë dhe kontigjenca	3,000,000
Rezervë për rritjen e pagave	2,430,000
Interesat	25,085,000
Për borxhin e brendshëm	21,985,000
Për borxhin e huaj	3,100,000
Granti për pushtetin vendor	12,499,916
Granti nga pushteti vendor	9,499,910
Nga të ardhurat e veta	3,000,000
Totali	43,014,816

V E N D I M

Nr. 237, datë 6.6.2002

PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.205, DATË 13.4.1999 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE "PËR DISPOZITAT ZBATUESE TË KODIT DOGANOR", ME NDRYSHIMET PËRKATËSE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 4 të nenit 199 të ligjit nr.8449, datë 27.1.1998 "Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë", me ndryshimet përkatëse, me propozimin e Ministrit të Financave dhe të Ministrit të Shtetit pranë Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

Në vendimin nr. 205, datë 13.4.1999 të Këshillit të Ministrave, me ndryshimet përkatëse, të bëhen këto ndryshime:

- Nënpiakat "i)" dhe "ii)" të shkronjave "a" dhe "b" të pikës 254 shfuqizohen.
 - Fjalja e dytë dhe fjalja e tretë e pikës 255.1 shfuqizohen.
- Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Pandeli Majko

V E N D I M
Nr. 240, datë 6.6.2001

PËR MËNYRËN E NDARJES SË TË ARDHURAVE QË VIJNË NGA MARRËVESHJET
E QIRASË SË "PERSONAVE TË STIMULUAR" NË FUSHËN TURISTIKE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 14 dhe 21 të ligjit nr. 7512, datë 10.8.1991 "Për sanksionimin dhe mbrojtjen e pronës private, të nismës së lirë, të veprimtarive private të pavarur dhe privatizimit", ndryshur me ligjet përkatëse, dhe të shkronjës "ç" të nenit 7 të ligjit nr.7665, datë 21.1.1993 "Për zhvillimin e zonave që kanë përparësi turizmin", me propozimin e Ministrit të Rregullimit të Territorit dhe Turizmit, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Të ardhurat e realizuara nga marrëveshjet e qirasë, të lidhura ndërmjet Ministrisë së Rregullimit të Territorit dhe Turizmit dhe "personave të stimuluar" në fushën e turizmit, të ndahen si më poshtë vijon:

- 30 për qind në buxhetin e Ministrisë së Rregullimit të Territorit dhe Turizmit;
- 70 për qind në Buxhetin e Shtetit.

2. Ministria e Rregullimit të Territorit dhe Turizmit t'i përdorë këto fonde për zhvillimin e infrastrukturës së turizmit dhe për promocion.

3. Ngarkohen Ministria e Rregullimit të Territorit dhe Turizmit dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Pandeli Majko

V E N D I M
Nr. 242, datë 6.6.2002

PËR KRIJIMIN E ZYRAVE RAJONALE TË TURIZMIT

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 9 të ligjit nr.7608, datë 22.9.1992 "Për prefekturat", ndryshuar me ligjin nr.8209, datë 22.4.1997, me propozimin e Ministrit të Rregullimit të Territorit dhe Turizmit, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Krijimin e zyrve rajonale të turizmit (ZRT), në përbërje të prefekturave të qarqeve: Shkodër, Durrës, Vlorë, Korçë, Tiranë, Berat dhe Gjirokastrë.

2. Zyrat rajonale të turizmit ushtrojnë këto detyra:

- Hartojnë strategji rajonale, në përputhje me strategjinë e përgjithshme, të miratuar, të zhvillimit turistik të vendit dhe ndihmojnë në realizimin e tyre;

- mbikëqyrin veprimtaritë turistike rajonale, mbështesin kontrollin për vëzhgimin e rregullave të etikës profesionale në fushën e turizmit;

- ofrojnë objekte turistike për kategorizimin e tyre, në përputhje me kriteret e vëna nga Ministria e Rregullimit të Territorit dhe Turizmit.

- shpërndajnë të dhëna dhe kryejnë veprimtari promociionale, rajonale;

- ndihmojnë në grumbullimin e statistikave dhe të dhënave turistike në rajonin ku veprojnë;

- kontrollojnë realizimin e investimeve në zonat ku janë miratuar dhe kryejnë shërbimin këshillimor për procedurat e miratimit të projekteve të reja investuese në zonat turistike;

- raportojnë një herë në muaj në Ministrinë e Rregullimit të Territorit dhe Turizmit për të gjitha problemet.

3. Në strukturat organike të prefekturave të qarqeve Shkodër, Durrës, Vlorë, Korçë, Tiranë, Berat dhe Gjirokastrë të shtohet nga një punonjës për të mbuluar veprimtarinë e zyrve rajonale të turizmit.

4. Zyrat rajonale të turizmit, administrativisht, janë në varësi të prefektit të qarkut, ndërsa përsa i përket drejtimit metodik, ato varen nga Ministri i Rregullimit të Territorit dhe Turizmit.

5. Veprimtaria, funksionimi, procedurat e emërimit dhe detyrat organizative të këtyre përcaktohen me udhëzim të përbashkët të Ministrisë të Rregullimit të Territorit dhe Turizmit dhe të Ministrisë të Pushtetit Vendor dhe Decentralizimit.

6. Përfundimisht, për vitin 2002, efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga buxheti i vitit 2002, miratuar për Ministrinë e Rregullimit të Territorit dhe Turizmit.

7. Ngarkohen Ministria e Rregullimit të Territorit dhe Turizmit, Ministria e Financave, Ministria e Pushtetit Vendor dhe Decentralizimit, si dhe prefektët e qarqeve Shkodër, Durrës, Vlorë, Korçë, Tiranë, Berat dhe Gjirokastrë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Pandeli Majko

VE N D I M Nr. 115, datë 6.6.2002

“NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË”

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Fehmi Abdiu	Kryetar i Gjykatës Kushtetuese
Zija Vuci	Anëtar i “““
Gjergj Sauli	Anëtar i “““
Alfred Karamuço	Anëtar i “““
Kristofor Peçi	Anëtar i “““
Kujtim Puto	Anëtar i “““
Petrit Plloçi	Anëtar i “““
Sokol Sadushi	Anëtar i “““

me sekretare Arbenka Lalica, në datën 19.4.2002, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura çështjen nr. 80 Akti që i përket:

KËRKUES: AGRON VRETO, përfaqësuar nga avokate Hanëme Bakia.

SUBJEKTE TË INTERESUARA:

1. SOKOL MARA, përfaqësuar nga avokat Dashmir Kore, me prokurë.

2. SUZANA MARA, përfaqësuar nga avokat Dashamir Kore, me prokurë.
3. NDËRMARRJA KOMUNALE BANESA NR.2 TIRANË, përfaqësuar nga Florenca Demneri, me autorizim.

OBJEKTI: Shfuqizimi si antikushtetutes i vendimeve nr. 1234, datë 15.12.2000 të Gjykatës së Apelit të Tiranës dhe nr. 12, datë 10.1.2002 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë.

Kërkuesi pretendon se vendimet e sipërcituara janë antikushtetuese, pasi i kanë shkelur të drejtën për një proces të rregullt ligjor, duke parashtruar këto shkaqe:

- Në përbërje të trupit gjykues në Kolegjin Civil të Gjykatës së Lartë, në Dhomën e Këshillimit, ka marrë pjesë i njëjti gjyqtar, i cili, kur kjo çështje është shqyrtuar nga kjo Gjykatë më parë, ka shprehur mendim për themelimin e çështjes, të arsyetuar me shkrim në një mendim pakice. Pjesëmarrjen e të njëjtit gjyqtar të Gjykatës së Lartë në këtë proces kërkuesi e konsideron shkelje të nenit 72/4 të Kodit të Procedurës Civile dhe cenim të parimit të paanësisë në gjykim.

- Gjykata e Apelit të Tiranës nuk ka respektuar detyrat e dhëna nga Gjykata e Lartë, duke shkelur kërkesat e nenit 486 të Kodit të Procedurës Civile. Dhënia e vendimit nga gjykata e apelit, në kundërshtim me detyrat e caktuara nga Gjykata e Lartë, si dhe me ligjin material, janë rrjedhojë e një procesi të parregullt ligjor.

- Në rekurs janë ngritur shkaqe ligjore, por Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, ka shkelur kërkesat e nenit 472 shkronja “a” dhe “b”, duke vendosur mospranimin e rekursit.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes Sokol Sadushi, përfaqësuesen e kërkuesit, përfaqësuesin e subjekteve të interesuara dhe shqyrtoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

Në shqyrtimin e kësaj çështjeje, mendimet e anëtarëve të Gjykatës Kushtetuese u ndanë në një mënyrë që nuk arrihej të votohej asnjë përfundim i çështjes. Arsyeja kryesore lidhet me përbërjen e saj që në këtë çështje nuk ishte e plotë.

Në këto kushte, meqënëse votat e anëtarëve u ndanë në mënyrë të barabartë, gjë që ndikon në mosmarrjen e një vendimi përfundimtar nga Gjykata Kushtetuese dhe duke qenë se ekziston mundësia që në të ardhmen me plotësimin e numrit të nevojshëm të vendimmarrjes së Gjykatës kjo çështje mund të rishqyrtohet përsëri, kërkesa duhet të refuzohet.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në bazë të neneve 131/f dhe 132 të Kushtetutës, si dhe nenit 74 të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”,

V E N D O S I:

- Rrëzimin e kërkesës.
- Ky vendim hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

V E N D I M Nr. 117, datë 6.6.2002

“NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË”

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Fehmi Abdiu	Kryetar i Gjykatës Kushtetuese
Zija Vuci	Anëtar i “““
Gjergj Sauli,	Anëtar i “““
Alfred Karamuço	Anëtar i “““
Kujtim Puto	Anëtar i “““
Petrit Plloçi	Anëtar i “““
Sokol Sadushi	Anëtar i “““
Kristofor Peçi	Anëtar i “““

me sekretare Arbenka Lalica, në datën 3.6.2002, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura çështjen nr.119 Akti që i përket:

KëRKUES:ARBEN BROJA, përfaqësuar nga avokat Mirash Martini, me deklaram.

SUBJEKT I INTERESUAR:

1. KRISTO GOÇI, përfaqësuar nga avokate Hanëme Bakia, me deklaram.
2. KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE, përfaqësuar nga juristja Dëshira Mataj, me autorizim.

OBJEKTI:Shfuqizimi si antikushtetues i vendimit nr.44, datë 23.5.2002 të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

BAZA LIGJORE:Nenet 81 dhe 141 të Kodit Zgjedhor.

Për shfuqizimin e këtij vendimi kërkuesi parashtron:

- Vendimi i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, që shpall deputet zotin Kristo Goçi, është në kundërshtim me nenin 81/2 të Kodit Zgjedhor, që përcakton se në rast dorëheqje të një kandidati, vazhdohet me kandidatin pasues në renditje.

- Heqja dorë nga kandidimi i zotit Kristo Goçi provohet me deklaratën e nënshkruar prej tij.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes Kristofor Peçi, përfaqësuesit e kërkuesit, të subjekteve të interesuara dhe shqyrtoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

Kuvendi i Shqipërisë, me shkresën nr.1263, datë 15.5.2002, në mbështetje të nenit 11 pikat 1 dhe 2 të Kodit Zgjedhor, ka kërkuar nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve të kryhejë të gjitha procedurat për plotësimin e vendit vakant të një deputeti nga lista shumemërore e PBDNj-së.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, me vendimin nr.44, datë 23.05.2002, ka vendosur që vendi vakant të plotësohet nga kandidati Kristo Goçi, i cili renditej i katërti në listën shumemërore të PBDNj-së.

Kërkuesi Arben Broja pretendon se është ai kandidati pasues në listë meqënëse kanë hequr dorë nga kandidimi 23 kandidatë dhe është përpiluar me renditje sipas numurit më të madh të votave të marra në votimin e drejtpërdrejtë një listë e dytë, në të cilën ai figuron i treti.

Gjykata Kushtetuese çmon se ky pretendim i kërkuesit nuk ka asnjë bazë. Sipas neneve 76 e 81/1 të Kodit Zgjedhor, lista shumemërore paraqitet në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve jo më vonë se 22 ditë para datës së zgjedhjeve dhe vendimi për pranimin ose mospranimin merret jo më vonë se 19 ditë para datës së zgjedhjeve. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, në datën 4.6.2001 ka pranuar listën shumemërore të dorëzuar nga PBDNj-ja, në të cilën kandidati Kristo Goxhi renditet i katërti, ndërsa kërkuesi Arben Broja ka numurin rendor 25. Në datën 1.8.2001, PBDNj-ja paraqet një listë të dytë, në të cilën kërkuesi renditet i treti. Së bashku me këtë listë, në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve dorëzohen edhe 23 deklarata të kandidatëve që kanë hequr dorë nga kandidimi. Mbi këtë bazë, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, me vendimin nr.233, datë 21.8.2001, ka shpallur listën e deputetëve të PBDNj-së, të cilët përfitojnë nga ndarja e mandateve plotësuese, duke caktuar në vendin e tretë

kandidatin Arben Broja. Ky vendim i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve është shfuqizuar nga Gjykata Kushtetuese me vendimin e saj nr.114, datë 27.8.2001. Sipas këtij vendimi, paligjshmëria e vendimit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve konsiston në disa drejtime:

Së pari, tërheqja nga kandidimi nuk i jep të drejtë askujt të bëjë ndryshime në listat shumëmemërore të vërtetuara.

Së dyti, me miratimin e këtyre listave kandidatët e regjistruar në to fitojnë cilësinë e subjektit zgjedhor. Pra, janë vetë ata që disponojnë mbi të drejtën për t'u zgjedhur dhe jo partitë politike. Dorëheqja e tyre nga e drejta e kandidimit është një akt personal, prandaj është vetë kandidati që duhet t'i drejtohet me kërkesë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve dhe jo partitë politike.

Së treti, kriteri për ndarjen e mandateve shtesë që kandidatët të shpallen fitues sipas numurit të votave të fituara në votimin e drejtpërdrejtë, është i paligjshëm, sepse jo vetëm që nuk rezulton të jetë pasqyruar në ndonjë akt shkresor, por nuk i është kërkuar Komisionit Qendror të Zgjedhjeve brenda afateve të parashikuara nga Kodi Zgjedhor.

Është parim i mirënjohur se rregullat e administrimit të zgjedhjeve nuk mund të ndryshohen gjatë procesit zgjedhor. Ky parim është zbatuar nga Gjykata Kushtetuese edhe në vendimin nr.115, datë 28.8.2001, ku trajtohet çështja e paraqitjes së listave dhe renditjes së kandidatëve në to. Duke iu referuar neneve 81 e vijues të Kodit Zgjedhor, në vendim arsyetohet se: "Sipas këtyre dispozitave, renditja e kandidatëve në listë caktohet nga subjekti zgjedhor që e paraqet atë dhe se emrat e listës shumëmemërore nuk mund të ndryshohen". Gjithashtu, në këtë vendim arsyetohet se marrëveshja e partive ka efekt për hartimin e listës shumëmemërore para se të vërtetohet nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve. Pas kësaj, asnjë marrëveshje e partive nuk mund të ketë efekt mbi listën.

Këto arsyetime ligjore të bëra nga Gjykata Kushtetuese në vendimet e saj, me të drejtë, janë marrë në konsideratë dhe janë zbatuar nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve në vendimin e tij nr.44, datë 23.5.2002 që përbën edhe objektin e këtij gjykimi. Në këtë vendim përmendet se në mbështetje të urdhërimeve të Gjykatës Kushtetuese të bëra me vendimin e saj nr.114, datë 27.08.2001, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve duhet të respektojë renditjen e listës shumëmemërore të depozituar nga partitë ose koalicioni i partive. Në këto rrethana, duke zbatuar kriteret ligjore për renditjen e kandidatëve në listën shumëmemërore, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ka vendosur që vendi vakant i deputetit të plotësohet nga kandidati Kristo Goçi, që renditej i katërti në listë dhe jo nga kërkuesi Arben Broja, i cili mban numurin rendor 25.

Këtë vendim të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve Gjykata Kushtetuese e gjen të bazuar në dispozitat e Kodit Zgjedhor dhe në praktikën e saj. Duke konfirmuar qëndrimin e mbajtur në vendimet e saj të mëparshme, kjo Gjykatë thekson se, përveç argumenteve të mësipërme, për çështjen në shqyrtim u vërtetua se personi i interesuar Kristo Goçi në datat 3.7.2001 dhe 3.8.2001, ka deklaruar para noterit se nuk ka hequr dorë nga kandidimi. Ky deklaram i tij, i bërë para marrjes së vendimit nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve për plotësimin e vendit vakant nga kandidati i radhës në listë, e bën të pavlefshme çdo dorëheqje të mëparshme edhe sikur të ketë të tillë.

Përsa i përket pretendimit të kërkuesit për dorëheqje të kandidatëve që janë më përpara në listë, Gjykata Kushtetuese, çmon se nga dokumentacioni i administruar nuk vërtetohet një dorëheqje e tillë në kuptim të nenit 81/2 të Kodit Zgjedhor, por në fakt është një veprim për ndryshimin e renditjes së kandidatëve në listë, duke u dhënë përparësi kandidatëve që kanë marrë më shumë vota në zgjedhjet e drejtpërdrejta. Megjithatë nga përmbajtja e deklaratave (të cilat janë në një format tip)

del se tërhiqet kërkesa për të kandiduar për deputet në listën shumëmemërore të PBDNJ-së, në fakt nuk ka ndodhur kështu, por është hartuar një listë tjetër në të cilën marrin pjesë edhe 23 kandidatët që kanë deklaruar dorëheqjen. Kjo listë i është dërguar Komisionit Qendror të Zgjedhjeve me shkresën nr.508, datë 1.8.2001 dhe është mbajtur parasysht e vlerësuar nga ky i fundit në vendimin e tij nr.233, datë 21.8.2001, duke shpallur deputet të listës kërkuesin Arben Broja.

Prandaj, edhe në këtë aspekt, deklarata e paraqitur nga kërkuesi në emër të Kristo Goçit për të vërtetuar heqjen dorë të këtij të fundit nga kandidimi, nuk ka asnjë vlerë, sepse ajo nuk përbën dorëheqje në kuptim të nenit 81/2 të Kodit Zgjedhor dhe nuk i jep mundësinë kandidatit pasues në listë për të fituar mandatin e deputetit.

Duke marrë në konsideratë argumentet si më sipër, Gjykata Kushtetuese, arrin në përfundimin se vendimi nr.44, datë 23.05.2002 i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve është i drejtë dhe i bazuar, prandaj kërkesa për shfuqizimin e tij duhet rrëzuar.

PËR KETO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në bazë të nenit 131 të Kushtetutës, neneve 26 dhe 72 të ligjit nr.8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, neneve 113 e 141 të Kodit Zgjedhor, me shumicë votash,

V E N D O S I:

- Rrëzimin e kërkesës.
- Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi menjëherë.

V E N D I M

Sipas kërkesës së bërë nga Iris Ferhati, e bija e Mahmutit dhe e Baries, lindur më 1965 në Sotir të Gramshit dhe banuese në fshatin Darzezë, komuna Dermenas, Fier, Gjykata e Shkallës së Parë të Rrethit Gjyqësor të Fierit vendosi të shpallet i zhdukur bashkëshorti Halit Shaban Ferhati që prej datës 30.4.1991.

KËRKESË

Kërkuese: Engjëllushe Zeria, e bija e Allamanit dhe e Merjemes, lindur më 1968 në Brezhdan dhe banuese në fshatin Grevë.

Objekti: Kërkoj të shpallet i zhdukur bashkëshorti Hysen Zeria, banues në fshatin Grevë të Dibrës.

Në vitin 1996 bashkëshorti im është larguar si emigrant në Itali. Që nga ky vit kanë kaluar 6 vjet dhe nuk kemi asnjë të dhënë për fatin e tij, prandaj kërkoj të shpallet i zhdukur.

KËRKUESE
Engjëllushe Zeria

V E N D I M (I SHKURTUAR)

Gjykata e Shkallës së Parë të rrethit Gjyqësor në Korçë vendosi heqjen e zotësisë për të vepruar të shtetasit Fejzi Sherif Kotori, lindur më 1940 dhe vënien në kujdestarinë e përkohshme të motrës së tij Arta Tora.

KËRKESË

Kërkuese: Anila Kaferi (Lazri), e bija e Gafurrit dhe e Shazijes, lindur më 1975 dhe banuese në fshatin Bllatë e Epërme të Komunës Maqellarë të rrethit Dibër.

Objekti: Kërkoj të shpallet i zhdukur bashkëshorti im Zenel Kaferi, pasi është nisur për në Itali nga Vlora më 11 mars 1996. Që nga ajo kohë dhe deri më sot nuk kemi asnjë të dhënë për fatin e tij, prandaj kërkoj të shpallet i zhdukur.

KËRKUESE
Anila Kaferi

Fletorja Zyrtare gjendet:

- Në çdo njësi postare të çdo qyteti;
- Pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare:
Rr.Qemal Stafa, pranë ndërtesës së Prokurorisë së Përgjithshme.

U dorëzua për shtyp më 17. 6. 2002
Doli nga shtypi më 18. 6. 2002

Tirazhi: 4250 copë	Formati: 60x88/8
--------------------	------------------

Shtypshkronja e Qendrës së Publikimeve Zyrtare
Tiranë, 2002

Çmimi: 150 lekë